



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA E PËRGJITHSHME

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË APELIT TIRANË

Analizë vjetore mbi punën e Prokurorisë së Apelit Tiranë për vitin 2017

Të nderuar kolegë,

Analiza e punës së Prokurorisë së Apelit Tiranë për vitin 2017, zhvillohet sot nën dritën e ndryshimeve thelbësore që shoqërojnë sistemin e drejtësisë në vendin tonë. Miratimi i ndryshimeve kushtetuese dhe paketa ligjore, për reformimin e sistemit të drejtësisë kanë në fokusin e tyre, angazhimin maksimal të të gjithë faktorëve dhe aktorëve në vend, por mbi të gjitha angazhimin e drejtëpërdrejtë të trupës së gjyqtarëve dhe prokurorëve, për të rikthyer besimin e publikut te drejtësia, ku forca e ligjit vlen për të gjithë në mënyrë të barabartë, në përmbushje dhe respekt të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Ndërtimi i shtetit ligjor dhe demokracisë, krijimi i një sistemi drejtësie të besueshëm, të drejtë, të përgjegjshëm dhe eficient, të pavarur, profesional dhe të orientuar drejt një shërbimi transparent ndaj publikut, goditja e krimit të organizuar në të gjitha format e tij, intesifikimi i luftës kundër terrorizmit dhe krimit ndërkombëtar, lufta kundër korrupsionit, në respekt të plotë të ligjeve të vendit dhe të angazhimeve ndaj partnerëve tanë ndërkombëtarë, përbëjnë sot, sfidat kryesore me të cilat përballet shoqëria shqiptare.

Për sa i përket forcimit të bashkëpunimit institucional, prioritet mbetet lufta kundër kriminalitetit, trafikeve, pastrimit të parave në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Në këtë kuadër, është kërkuar dhe kërkohet vazhdimisht, rritja e rolit të prokurorit dhe, shkëmbimi i informacionit dhe dokumentimit të veprave penale, si dhe rritje të kapaciteteve profesionale të oficerëve të policisë gjyqësore.

Të bësh bilancin e punës së vitit që lamë pas, padyshim është një çështje që kërkon vëmendjen e duhur për të analizuar të gjithë komponentët përbërës të punës sonë, me treguesit pozitivë, por edhe problematikat e hasura. Kjo analiza e punës së Prokurorisë së Apelit Tiranë për vitin 2017, pasqyron në mënyrë të përmbledhur këta tregues.

Arritjet dhe problematikat e konstatuara gjatë punës do të pasqyrojnë sfidat, me të cilat jemi përballur. Gjatë vitit që kemi lënë pas, e gjithë trupa e prokurorëve ka treguar përkushtim profesional dhe eficensë të plotë në përfaqësimin e çështjeve në Gjykatën e Apelit Tiranë. Për nga numri dhe rëndësia e çështjeve që trajtojmë ne mbetemi një hallkë e rëndësishme, pasi shqyrtojmë numrin më të madh të çështjeve në shkallë vendi që gjykohen në shkallë të dytë. Në punën tonë tashmë ne mbështetemi në zbatimin sa më rigoroz të ligjit penal dhe procedural, duke mbajtur parasysh faktin se tash, Prokuroria është organ i decentralizuar. Në përmbushjen e detyrës sonë, gjithsecili nga ne është mbështetur në parimin kushtetues të ushtrimit të ndjekjes penale dhe respektimit të ligjit. Ushtrimi i kompetencave, duke respektuar parimet e procedimit të drejtë, të barabartë e të rregullt ligjor dhe mbrojtjes së të drejtave, interesave dhe lirive të themelore të njeriut do të jetë gjithnjë motoja e punës sonë.

Për ta patur sukses është shumë e rëndësishme organizimi i punës dhe shpërndarja e saj, me qëllimin e përfaqësimit sa më dinjitoz në gjyq. Ndarja e çështjeve të themelit është bërë mbi bazën e shortit manual, ndërsa për masat e sigurimit, kjo ndarje bëhet mbi bazën e grafikut të gatishmërisë.

Për çështjet e themelit është treguar kujdes, që trajtimi dhe ndarja e çështjeve midis prokurorëve të jetë pak a shumë e barabartë, jo vetëm duke u nisur nga numri, por edhe

nga shkalla e rrezikshmërisë dhe e rëndësisë së çështjes, numrit të të pandehurve, ndarje në mënyrë të barabartë të çështjeve, që gjykohen në apel mbi bazën e ankimeve të prokurorëve dhe ankimeve të bëra nga të pandehurit.

Në funksion të përmbushjes së detyrave, rol të rëndësishëm luan administrata e prokurorisë, e cila në bashkëveprim me administratën e Gjykatës së Apelit e, nën kujdesin e kryetarit të saj, bëjnë të mundur vënien në dispozicion të materialeve dhe praktikave të dosjeve, për të garantuar studimin e tyre nga ana e prokurorëve. Pikërisht, falë këtij organizimi, bëhet e mundur që prokurorëve t'u mundësohet studimi i çështjeve në kohë, për një përfaqësim sa më të shpejtë e dinjitoz në gjykatë. Natyrisht, këtu një vend të veçantë zë bashkëpunimi dhe koordinimi me kryetarin e gjykatës, i cili nëpërmjet vënies në dispozicion të burimeve njerëzore e materiale, ka mundësuar realizimin dhe përmbushjen në kohë të detyrave tona.

Gjithashtu, bashkëpunimi me drejtoritë përkatëse në Prokurorinë e Përgjithshme ka qenë i vazhdueshëm dhe ka qenë një ndihmë në realizimin e detyrave të prokurorëve.

Me qëllim që puna jonë të jetë e pasqyruar, transparente dhe e kontrollueshme në çdo kohë, ne vazhdojmë praktikën e paraqitjes në gjykatë të konkluzioneve tona me shkrim, në funksion të qëndrimeve ligjore të unifikuara gjatë gjykimeve. Po kështu, për çdo çështje masë sigurimi, themeli etj, nga ana jonë mbahet në arshivë një minidosje, e cila përmban aktet kryesore të çështjes së gjykuar.

Një rëndësi të veçantë, i kam kushtuar si drejtues, ushtrimit të funksioneve të secilit prokuror brenda kodit të etikës. Është pjesë e suksesit të punës, jo vetëm paraqitja në seancë gjyqëore në datën, orën e caktuar, por dhe mënyra e komunikimit me trupin gjykues dhe palët në proces, paraqitja e jashtme dinjitoze, respektimi i disiplinës në punë, për të cilat gjej rastin të falenderoj të gjithë kolegët.

Më lejoni të parashtroj konkretisht, treguesit e punës për vitin 2017, bazuar në të dhënat tona.

Kështu, në Prokurorinë Apelit Tiranë gjatë vitit 2017, është përballuar një volum pune i madh për çështje themeli e masa sigurimi.

Prokuroria e Apelit Tiranë ka përfaqësuar në gjykim në Gjykatën e Apelit Tiranë, **1804 çështje penale në themel, me 2182 të pandehur**. Duke krahasuar numrin e çështjeve të gjykuara në Gjykatën e Apelit Tiranë me *vitin 2016*, ku janë gjykuar **1895 çështje penale në themel, me 2227 të pandehur**, numri i çështjeve ka një ulje prej 90 çështje.

Për sa i përket masave të sigurimit në Gjykatën e Apelit janë gjykuar **1396 masa sigurimi personal**. Krahasuar me *vitin 2016*, ku janë **gjykuar 2024 masa sigurimi personal, ka një ulje të lehtë**.

Prokurorët i kanë kushtuar kujdes të veçantë studimit të çështjeve të themelit, për t'u përfaqësuar me cilësi në gjyq. Për çështjet më problematike, me shumë të pandehur dhe për akuza të rënda, janë bërë diskutime me kolegët dhe drejtuesin, para përfaqësimit në gjyq. Për sa i përket çështjeve të themelit, kanë ardhur dhe janë gjykuar, mbi *apelin e prokurorit 625 çështje ose 34,6 %* dhe mbi *ankimin e të pandehurve 1179 çështje ose 65,4 % të rasteve*. Ndërsa, për sa i përket *masave të sigurimit në 1396 raste, 202 raste* kanë ardhur në Prokurorinë e Apelit *mbi bazën e apelit të Prokurorit ose 14,5 % dhe në 1194 raste* kanë ardhur mbi *ankimin e të pandehurve ose 86,5 %*.

Rëndësi të veçantë në punën e prokurorëve ka patur studimi i apeleve të prokurorëve. Kështu, **625 çështje** janë mbi apelin e prokurorit. Nga këto, nga prokurorët e apelit, nuk janë mbështetur 311 *apele ose 49,7 %*. Ne 38 raste ose 6 % të ardhura mbi apelin e prokurorit është kërkuar pushimi i çështjes për shkak të ligjit mbi amnistinë. Rastet e heqjeve dorë nga prokurorët, janë të bazuara në kritere ligjore dhe kryesisht kanë të bëjnë me apele për masa dënimi për vepra me rrezikshmëri jo të lartë shoqërore. Gjithashtu heqjet dorë janë bërë pas një studimi të standartit të viteve të fundit të vendosur në praktike nga Gjykata e Apelit, pra për çështje të cilat ishin të humbura nga ne. Ky qendrim ka sjellë një rritje të efikasitetit të punës sonë, duke sjellë rritjen e përqindjes së apeleve të mbështetura nga Gjykata e Apelit.

Prokurorët kanë përkrahur apelet në shumicën e rasteve. Për çështje themeli Gjykata e Apelit Tiranë, *nga 275 apele të përkrahura nga prokurori, ka pranuar apelet e prokurorit në 64 raste ose rreth 23,3 %*. Kjo përqindje krahasuar me përqindjen e pranimit të apeleve në vitin 2016 (17, 8 %) ka një rritje të dukshme.

Në 1315 raste, nga prokurorët e apelit, është kërkuar lënia në fuqi e vendimit. Nga këto, gjykata ka vendosur lënien në fuqi të vendimit *në 1140 raste ose 86,7 %*. Nga 1590 çështje të gjykuara në Gjykatën e Apelit Tiranë, mbi kërkesat e prokurorëve për lënie në fuqi dhe pranim apeli, janë pranuar konkluzionet e prokurorëve për 1204 çështje ose e shprehur në përqindje **75.7 %**. Ka një rritje të lehtë krahasuar me vitin 2016.

Gjatë vitit 2017 janë pushuar çështjet në 144 raste. Kjo, për shkak të ligjit për amnistinë.

Sipas rretheve apelet janë të shpërndara si më poshtë:

- Tirana ka 516 apele, janë përkrahur nga prokurori 211 apele dhe është hequr dorë ose mospranuar apeli në 305 raste, ndërsa gjykata ka pranuar apele 48.
- Kruja ka 13 apele, janë hequr dorë nga apelet ose mospranuar apeli në 7 raste, janë përkrahur 6 apele nga prokurori. Gjykata e Apelit ka pranuar 4 apele.
- Kurbini ka 55 apele, është hequr dorë ose mospranuar apeli në 19 raste dhe janë përkrahur 36 raste, ndërsa gjykata ka pranuar 9 apele .
- Dibra ka 19 apele, janë hequr dorë nga apeli ose mospranuar apeli në 9 raste, janë përkrahur 10 apele, ndërsa Gjykata e Apelit Tiranë nuk ka pranuar asnjë apel.
- Mati ka 22 apele, janë hequr dorë ose mospranuar apeli në 9 raste, janë përkrahur 13 apele dhe gjykata ka pranuar vetëm 3 apele.

Nga pasqyra e këtyre treguesve vërehet se, nuk janë përkrahur apelet për masa dënimi ku diferenca ka qenë e vogël dhe për vepra penale me rrezikshmëri të vogël shoqërore të veprës apo të personit nën hetim.

Në bazë të shprehjes së vullnetit nga vetë prokurorët, që kanë bërë hetimin, janë përfaqësuar çështjet nga prokurorët e shkallës së parë në Gjykatën e Apelit Tiranë, në 4 raste. Këto apele të përfaqësuara nga prokurorët e shkallës së parë nuk janë gjetur të bazuara dhe nuk janë përkrahur nga Gjykata e Apelit.

Në **1179 raste**, çështja ka ardhur në Gjykatën e Apelit Tiranë, mbi bazën e ankimit të të pandehurit. Në **13 raste ose 0,7 %** është kërkuar prishja e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë dhe është dërguar çështja për rigjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë. Të njëjtën linjë ka mbajtur dhe Gjykata e Apelit Tiranë, ku ka prishur dhe kthyer për rigjykim 13 çështje. Theksojmë, se në të gjitha këto çështje Gjykata e Apelit, ka pranuar kërkesën tonë, pasi janë konstatuar shkelje të rënda procedurale në gjykimin në shkallë të parë.

Në **144 raste ose 7,98 %**, është kërkuar nga ana jonë pushimi i çështjes për efekt të amnistisë dhe me të drejtë është pranuar nga gjykata.

Për sa i përket çështjeve të themelit, nga ana e prokurorit është kërkuar lehtësimi i pozitës së të pandehurit me **57 raste ose 3,2%**.

Për çështjet e themelit, prokurori ka kërkuar lehtësim pozite në 57 raste dhe pushim çështje në 144 raste. Të dhënat sipas prokurorëve janë shprehur sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Prokurori	Lehtësuar pozita	Pushuar Çështja
1	Altin Dumani	11	21
2	Dritan Peka	3	-
3	Edi Hyka	7	18
4	Gentian Trenova	6	11
5	Genti Xholi	4	14
6	Luan Kaloçi	9	19
7	Nezir Gjoka	4	21
8	A.Qosja	7	22
9	F.Memçaj	6	18
	Total	57	144

Në 1315 raste, nga prokurorët e apelit është kërkuar lënia në fuqi e vendimit. Nga këto, gjykata ka vendosur lënien në fuqi të vendimit në 1140 ose raste ose 86.7% , ka lehtësuar pozitën në 126 raste ose 9,6 %, ka pushuar çështjen në 27 raste ose 2 % dhe ka kthyer për rigjykim 22 raste ose 1,7%.

Nga këto tregues vihet re, se janë prishur dhe kthyer për rigjykim 13 çështje, ku të gjitha janë raste të gjykimit në mungesë, i cili nisur nga vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë, kërkon që në këto raste, bazuar në kriterin për një proces të rregullt ligjor, konstatohen shkelje procedurale për sa i përket njoftimit të të pandehurve dhe përfaqësimit të tyre në gjykim. Mendoj, se edhe këtu ka nevojë, që ky lloj gjykimi të rregullohet me ndyshime në K.Pr.Penale.

Është lehtësuar pozita e të pandehurit në 57 raste. Por, ky fakt ka të bëjë kryesisht me veprat penale të “drejtimit të mjetit në mënyrë të parregullt”, me ulje të vogla të masave të dënimit ose aplikimit brenda kritereve ligjore të neneve 59 dhe 53 të K.Penal, si dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake, neni 78 i K.Penal, si rezultat i ndryshimit të marzhit të dënimit për këtë vepër. Në të gjitha rastet, kur është dhënë pafajësi ose janë pushuar akuzat, nga ana jonë është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë.

Nga ana jonë është kërkuar përsëritja e shqyrtimit gjyqësor në disa çështje, por në masën më të madhe nuk është pranuar. Kjo mbetet një prioritet në marrëdhënie me gjykatën, pasi do t’a bënte gjykimin në apel të plotë e objektiv dhe do të reduktonte numrin e çështjeve, që prishen dhe kthehen nga Gjykata e Apelit për rigjykim.

Për sa i përket shpërndarjes së çështjeve sipas veprave penale, ato paraqiten si më poshtë:

- Neni 137 i K.Penal, janë gjykuar 200 çështje, me 206 të pandehur, me 7 të arrestuar;
- Neni 134 i K.Penal, janë gjykuar 154 çështje, me 211 të pandehur, me 133 të arrestuar;
- Neni 278/2 i K.Penal, janë gjykuar 71 çështje, me 87 të pandehur, 67 të arrestuar;
- Neni 279 i K.Penal, janë gjykuar 14 çështje, me 14 të pandehur, 8 të arrestuar;
- Neni 283 i K.Penal, me 103 çështje, 166 të pandehur, 157 të arrestuar;
- Neni 284 i K.Penal, me 32 çështje, 40 të pandehur, 25 të arrestuar;
- Neni 290 i K.Penal, me 34 çështje, me 34 të pandehur, 25 të arrestuar;
- Neni 291 i K.Penal, me 127 çështje, me 127 të pandehur;
- Neni 186 i K.Penal, me 21 çështje, me 37 të pandehur, 4 të arrestuar;
- Neni 189 i K.Penal, me 9 çështje, me 9 të pandehur, 1 të arrestuar;
- Neni 143 i K.Penal, me 65 çështje, me 84 të pandehur, 24 të arrestuar;
- Neni 139 i K.Penal, 38 çështje, me 52 të pandehur, 45 të arrestuar,;

- Neni 236 i K.Penal, 20 çështje, me 25 të pandehur, 3 të arrestuar;
- Neni 135 i K.Penal, 16 çështje, me 17 të pandehur, 5 të arrestuar;
- Neni 140 i K.Penal, 7 çështje, me 12 të pandehur, 11 të arrestuar.

Po kështu, vepra penale e vjedhjes, mbetet në vite me tregues të lartë. Gjithashtu, vërehet një rritje e numrit të veprave penale në fushën e prodhimit dhe shitjes së narkotikëve, ndërtimit pa leje, si dhe dhunës në familje. Gjithashtu, mbetet me përhapje të gjerë vepra penale e armëmbajtjes pa leje, çka na bën që goditjen e këtij fenomeni t'a realizojmë, nëpërmjet aplikimit të ashpërsimit të dënimit të kësaj vepre, në përshtatje me ndyshimet e fundit të K.Penal.

Nga numri i çështjeve në tërësi, Tirana zë numrin më të madh të çështjeve të gjykuara, 1475 çështje ose 81.8 %, më pas vjen Kurbini me 121 çështje ose 6,7 % të çështjeve, Kruja me 93 çështje ose 5,2%, Dibra me 62 çështje ose 3,4 % dhe Mati me 53 çështje ose 2,9 %.

Më poshtë, po ju paraqesim në mënyrë të përmbledhur ngarkesën e prokurorëve:

Për çështje themeli

Nr.	Prokurori	Çështje	Apele	Apel të pand	Pr.Apeli	H.Dore	Pr.Apeli Gjkata	Rekurse
1	Dritan Peka	89	22	67	4	18	1	1
2	Edmond Hyka	226	75	151	31	44	9	14
3	Nezir Gjoka	211	65	146	34	31	10	19
5	Genti Xholi	214	84	130	46	38	7	21

7	Gentian Trenova	207	76	131	22	54	4	12
8	Fatjona Memçaj	159	58	101	35	23	11	14
9	Altin Dumani	218	70	148	24	4.6	7	20
10	Arben Qosja	210	73	137	43	30	11	43
11	Luan Kaloci	270	102	168	37	65	4	8
	Total	1804	625	1179	276	349	64	152

Për sa i përket masave të sigurimit, kanë ardhur mbi apelin e prokurorit **202 raste ose 14,5 %** të rasteve. Nga ana e prokurorëve është hequr dorë ose mospranuar apeli i prokurorit në **87 raste ose 43.1 %**.

Kryesisht, nuk kemi përkrahur apelin e prokurorit, për “Arrest në burg”, pasi i kemi konsideruar vendimet e gjykatave të shkallëve të para të drejta. Këto masa (234, 237 të K.Pr.Penale) janë aplikuar për të mitur, nxënës apo studentë, për vepra penale me rrezikshmëri shoqërore të ulët, për vepra penale, të cilat janë inicuar me ankimin e të dëmtuarve.

Për sa i përket pranimit të apeleve për masat e sigurimit për vitin 2017 ka rritje. Gjykata e Apelit, nga 115 apele të përkrahur nga prokurori, ka përkrahur 50 apele ose rreth 43,5 % të apeleve.

Ndërsa, për masa sigurimi, apelet sipas rretheve janë:

- Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka 153 apele, është hequr dorë nga apeli në 63 raste, janë pranuar 90 raste dhe gjykata ka pranuar 38 raste ose 42 %;
- Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Dibër, ka 7 apele, është hequr dorë nga apeli në 4 raste, janë pranuar 3 apele, gjykata ka pranuar 1 apel ose 33,3%;

- Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Krujë, ka 13 apele, është hequr dorë në 7 raste, janë pranuar 6 apele, Gjykata e Apelit Tiranë ka pranuar 3 apele ose 50 %;
- Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kurbin, ka 31 apele, është pranuar 13 apele, është hequr dorë në 18 raste, gjykata ka pranuar 8 apele ose 44,4 %;
- Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Mat ka 4 apele, është hequr dorë nga apeli në 1 rast, janë pranuar 3 apele, gjykata nuk ka pranuar asnjë apel.

Për sa i përket masave të sigurimit, Tirana ka 1133 çështje ose 81.2% të çështjeve, Dibra 53 çështje ose 3,8 %, Kurbin 105 çështje ose 7,5 %, Kruja 75 çështje ose 5,4 % dhe Mati me 30 çështje ose 2,1 %.

Nga ana jonë është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë në 212 raste. Nga këto, *çështje themeli 152 dhe masa sigurimi 60*. Nga ky tregues del qartë, se kemi rekursuar një numër të madh çështjesh, për mendimin tonë, brenda kriterëve ligjorë. Gjithsesi, nuk kemi të dhëna të plota për mënyrën e përfundimit të këtyre çështjeve pas shqyrtimit në Gjykatën e Lartë.

Për sa i përket masave të sigurimit, nga ana e prokurorëve është kërkuar miratimi i vendimit në 844 raste, nga ana e gjykatës është miratuar vendimi në 753 raste ose rreth 89,2 % dhe është ndryshuar vendimi në 87 raste ose 10,2 % dhe në 5 raste është vendosur shfuqizimi i vendimit ose 0,6% .

Në 87 raste ose 6,2%, nga ana e prokurorëve është kërkuar ndryshimi i masës së sigurimit, kërkesë kjo e pranuar nga gjykata, në përputhje edhe me Kodin e Procedurës Penale.

Në Gjykatën e Apelit, gjatë vitit të kaluar janë gjykuar 380 çështje, me objekt shuarje masë sigurimi, ku në 355 raste nga prokurori është kërkuar shuarja e masës së sigurimit. Po kështu, ka vendosur edhe gjykata. Në 22 raste për shuarje masë sigurimi, është kërkuar rrëzimi i kërkesës, për faktin se i pandehuri nuk e kishte vuajtur dënimin e dhënë nga gjykata dhe, në 3 raste, është vendosur pushimi i gjykimit. Të njëjtën gjë ka vendosur edhe gjykata.

Shkaqet, që prokurorët kanë kërkuar ndyshimin e masës së sigurimit në një masë sigurimi më të butë kanë konsistuar në:

- Kanë ndyshuar kushtet, rrethanat dhe kriteret ligjore të vendosjes së tyre në Gjykatën e Shkallës së Parë, me kohën kur kjo masë është gjykuar në Gjykatën e Apelit.

-Faktit i është dhënë një kualifikim ligjor për një vepër penale më të lehtë se ajo, që është arrestuar në fillim.

-Është ndyshuar masa e sigurimit, nga arrest në burg, në masa sigurimi më të lehta për të miturit, që akuzohen për vepra penale të lehta (vjedhje në sasira tepër të vogla, përdorimi dhe mbatja në sasira të vogla të lëndëve narkotike të tipit cannabis sativa, etj.), të cilat për nga sasia e vogël dhe rrethanat e çështjeve konkrete krijohej bindja se këto çështje shkonin drejt pushimit të çështjes.

-Kanë ndryshuar kushtet dhe kriteret e vendosjes së masave të sigurimit, në kuptim të nenit 260 të K.Pr.Penale.

Nga ana e prokurorëve në Prokurorinë e Apelit Tiranë, është përballuar një volum i madh pune në studimin, përgatitjen e materialeve dhe përfaqësimin e çështjeve në gjyq për masa sigurimi. Siç e përmendëm edhe më lart, prokurorët në Prokurorinë e Apelit Tiranë janë përfaqësuar në Gjykatë në 1396 çështje për masa sigurimi personal e, më konkretisht:

Për masa sigurimi

Nr	Prokurori	Shuarje mase	masa	Total masa	Apele prok	Pr.Apel	H.Dore	Pranuar Gjykata	Nd. Masa	Rekurse
1	D.Peka	3		3						-

2	A.Dumani	38	99	137	18	10	8	5	4	12
3	A.Qosja	33	119	152	32	23	9	11		14
4	E.Hyka	44	188	232	29	15	14	10	17	2
5	F.Memçaj	24	81	105	10	8	2	4	2	3
7	G.Xholi	71	138	209	31	17	14	6	12	16
8	N.Gjoka	27	68	95	21	17	4	3	1	8
9	G.Ternova	56	184	240	24	10	14	7	29	5
10	L.Kaloçi	84	139	223	37	15	22	4	22	
	Total	380	1016	1396	202	115	87	50	87	60

Shpërndarja e çështjeve penale sipas veprave penale për masa sigurimi është si më poshtë:

Vepra penale e vjedhjes, sipas nenit 134, me 105 çështje, me 115 të pandehur, neni 291, me 37 çështje, me 37 të pandehur, neni 137, me 5 çështje, me 5 të pandehur, neni 278, me 35 çështje, me 35 të pandehur, neni 283, me 163 çështje, me 172 të pandehur, neni 248, me 20 çështje, me 21 të pandehur, neni 139, 30 çështje, me 33 të pandehur, neni 290, 44 çështje, me 44 të pandehur, neni 236, me 11 çështje, me 11 të pandehur, neni 143, me 22 çështje, me 22 të pandehur, neni 130, me 137 çështje, me 137 të pandehur.

Po kështu, në vitin 2017 janë ekzekutuar 726 urdhëra ekzekutimi. Në zbatimin e urdhërave të ekzekutimit është mbajtur parasysh ekzekutimi i tyre në kohë sa më të shpejtë sipas ligjit për ekzekutimet e vendimeve penale dhe urdhërit të Prokurorit të Përgjithshëm’.

Për vitin 2017, janë përgatitur dhe arshivuar të gjitha minidosjet e çështjeve të gjykuara në Gjykatën e Apelit Tiranë, në të cilën ruhen akte të tilla si: konkluzione të prokurorit të shkallës së parë, vendimi i gjykatës shkallës së parë, ankimet e prokurorit ose të të pandehurit, konkluzionet e prokurorit dhe vendimi i Gjykatës së Apelit, aktet e administruara në rastet, kur ka patur çelje të shqyrtimit gjyqësor dhe administrim të provave, si dhe rekurset e ushtruara.

Rezultatet e arritura deri më tash nga ana jonë për vitin 2017, kanë ardhur falë bashkëpunimit me drejtuesit dhe prokurorët e prokurorive të shkallëve të para, që mbulon Prokuroria e Apelit Tiranë, si dhe bashkëpunimi i ngushtë ligjor me Drejtorinë Gjyqësore.

Vlen të theksojmë gjithashtu, se arritjet e Prokurorisë së Apelit Tiranë gjatë vitit 2017, kanë ardhur edhe si rezultat i rritjes së bashkëpunimit ligjor të vendosur me gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë dhe me kryetarin e kësaj gjykate. Kushtet e punës janë përmirësuar, pasi tani gjyqet zhvillohen me regjistrim audio, dosjet vijnë nga gjykata në kohën e duhur për t'u studiuar nga ana jonë, zhvillimi i gjykimit bëhet brenda etikës së seancës gjyqësore, rritja e transparencës së gjykimeve, duke hedhur në faqen e internetit të gjykatës listat e gjyqeve dhe vendimet, përmirësimi i kushteve të sallave të zhvillimit të gjyqeve në Gjykatën e Apelit.

Vizioni, synimet që kërkohen të arrihen dhe përmirësimet në punën tonë, për vitin 2018

Pavarësisht rezultateve dhe treguesve pozitivë, ku vlen të theksohet përkushtimi dhe profesionalizmi i prokurorëve, në drejtim të rritjes cilësore të punës, mbetet ende për t' u bërë.

Nisur nga problematikat e hasura në praktikë, **sugjeroj:**

- Të punohet më shumë për të përgatitur konkluzione të plota, të argumentuara ligjërisht, në zbatim të drejtë të ligjit material e procedural, duke dalë, kur janë rastet, edhe përtej shkaqeve ligjore që ngrenë prokurorët e shkallës së parë në apelet e tyre.

- Kur hetimi i kryer në shkallë të parë nuk është i plotë dhe, për pasojë nuk krijohet bindje e plotë për kualifikimet ligjore apo plotësim të provave të çështjeve që gjykohen në apel, të kërkohet përsëritje e shqyrtimit gjyqësor dhe plotësimi i hetimit gjyqësor, duke kërkuar prova të tjera shtesë gjatë gjykimit në apel.

- Të vazhdohet të mbështeten apelet e prokurorëve për rëndim të pozitës së të pandehurit, për sa i përket masave të dënimit, kur diferenca, ndërmjet kërkesës së prokurorit dhe vendimit të gjykatës së shkallës së parë është e dukshme dhe për vepra penale me përhapje të gjerë, të tilla si: veprat penale në fushën e korrupsionit të zyrtarëve e nëpunësve të shtetit, armëmbajtje pa leje, krimet kundër jetës dhe shëndetit të shtetasve, krimet kundër pronës, mbajtja, përdorimi dhe tregtimi i lëndëve narkotike, shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor.

Në kuadër të ndryshimeve të shumta në Kodin e Procedurës Penale, ka lindur nevoja e krijimit të një praktike në zbatimin e këtyre normave procedurale. Prokurorët e apelit, duke qenë përfaqësues të akuzës në një shkallë më të lartë dhe duke patur mundësi të njihen me mënyrën e zbatimit të këtyre normave nga disa Gjykata të shkallës së parë, u lind detyra e unifikimit të mënyrës së interpretimit nga gjyqtarë dhe prokurorë të ndryshëm. Unifikimi i praktikës është i domosdoshëm jo vetëm në Prokurorinë e Apelit, por duhet tu transmetohet prokurorëve në shkallë të parë.

Në përfundim, dëshiroj të theksoj, se pavarësisht vështirësive dhe problematikave të hasura, ndryshimeve rrënjësore, kushtetuese dhe ligjore në sistemin e drejtësisë, sfidë kryesore për të ardhmen, mbetet mobilizimi dhe përdorimi i të gjitha burimeve njerëzore e materiale, me efektivitet, përgjegjshmëri, transparencë dhe cilësi,

përmirësimi i performancës dhe rritja e efikasitetit, duke shtuar numrin e çështjeve të fituara, për të bërë sadopak e kontribuar në kthimin e besimit të publikut në organet e drejtësisë.

Kjo, në drejtim edhe të përmbushjes së një prej kritereve të rëndësishme në procesin e integritimit në BE, atë të ndërtimit e konsolidimit të shtetit ligjor dhe të së drejtës.

Ju faleminderit!

DREJTUESI I PROKURORISË

Dritan PEKA

Tiranë, shkurt 2018